

Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të

Shoqërisë "TOP FRUITS" SHPK

Sot, më 29.01. 2024, u mblohd rregullisht Asambleja e Ortakëve të shoqërisë "TOP FRUITS" SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuara e themeluar dhe që operon sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, me numër unik të identifikimit të subjektit L34502401K, me seli në adresën: "Lagjia Karbunare e Poshtme" Autostradata Lushnje-Berat, kilometri i I-rë, nr.pasurie 839/29, Zona Kadastrale Nr. 2087", (në vijim referuar si "shoqëria")

Ortakët në vijim janë të pranishëm në mbledhje:

- **Z. Ejup Ahmeti**, shtetas shqiptar, lindur në Kosovë, më datë 07.05.1984, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaposrtës me numër SA7252442 dhe numër personal I40507112F, zotërues i kuotës që përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.
- **Shoqëria "GJONAJ GROUP HOLDINGS" SHPK**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuara e themeluar dhe që operon sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, me numër unik të identifikimit të subjektit M22010013H, me seli në adresën: Ndërtesa "Park Gate", Rruga e Elbasanit, Kati i I-rë, Tiranë, përfaqësuar nga Administratoria Znj. Kristiana Zhamo .

ME REND DITE:

- Miratimin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë "TOP FRUITS" SHPK në vlerën ALL 103,860,000 (EUR 1,000,000 Kursi 103.86), me kontributin prej ALL 51,930,000 (EUR 500,000 kursi 103.86) nga secili ortak. Kapitali i shoqerise pas zmadhimit nga 284,915,348 ALL do te behet 388,775,348 ALL. Z.Ejup Ahmeti do te zoteroje një kuote që përfaqëson 50% të kapitalit të shoqerise ne vlerë ALL 194,387,674 dhe shoqëria "GJONAJ GROUP HOLDINGS" SHPK do te zoteroje një kuote që përfaqëson 50% të kapitalit të shoqerise ne vleren ALL 194,387,674.

X. 26.

- Dhënien e pëlgimit që huaja që shoqëria "TOP FRUITS" SHPK ka ndaj ortakut Ejup Ahmeti në vlerën EUR 155,000 sipas Kontratës së Huazimit datë 23.11.2023 të kalojë si investim i ortakut Ejup Ahmeti në zmadhimin e kapitalit të shoqërisë sipas kundravleres ne lek ALL 16,098,300 (EUR 155,000 kursi 103.86)
- Autorizimin e administratorit të shoqërisë, Z. Gentian Jahja për të kryer aplikimet dhe veprimet e nevojshme për regjistrimin e këtij vendimi në QKB.
- Urdhërohet zyra e financës të kryerjë përshtatjet e nevojshme në kontabilitetin e shoqërisë në zbatim të këtij vendimi.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, pasi

**KONSTATOI:**

Ortakët e shoqërisë kanë vendosur të zmadhojnë kapitalin e shoqërisë "TOP FRUITS" SHPK me vlerën totale prej ALL 103,860,000 ( EUR 1,000,000 kursi 103.86), duke kontribuar secili prej tyre në vlerën ALL 51,930,000 (EUR 500,000 kursi dt 29.01.2024 103.86). Shlyerja e kapitalit të zmadhuar do të kryhet nga secili ortak brenda 7 (shtatë) ditëve nga nënshkrimi i këtij vendimi.

Ortaku Ejup Ahmeti ka nënshkruar me shoqërinë Kontratën e Huazimit datë 23.11.2023, nëpërmjet së cilës i ka dhënë shoqërisë një hua në shumën EUR 155,000 (njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë Euro), të cilën kërkon ta kalojë si pjesë të investimit të tij prej ALL 51,930,000 (EUR 500,000 kursi 103.86) duke financuar me fondet e veta pjesën tjetër të investimit në kapitalin e shoqërisë në vlerën prej ALL 35,831,700 (EUR 345,000 kursi 103.86)

Ortaku GJONAJ GROUP HOLDINGS SHPK do të shlyejë pjesën e tij të zmadhimit të kapitalit nëpërmjet fondeve të saj.

Sa më sipër, duke e konsideruar të rregullt thirrjen e mbledhjes së Asambleës së Përgjithshme të Ortakëve dhe në përputhje me interesat e shoqërisë miratimin e pikave të rendit të ditës, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë, me unanimitet:

VENDOSI:

- Të miratojë zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "TOP FRUITS" SHPK në vlerën ALL 103,860,000 (EUR 1,000,000 kursi 103.86) me kontributin prej ALL 51,930,000 (EUR 500,000 kursi 103.86) nga secili ortak. Kapitali i shoqerise pas zmadhimit nga 284,915,348 ALL do te behet 388,775,348 ALL. Z.Ejup Ahmeti do te zoteroje një kuote që perfaqeson 50% te kapitalit te shoqerise ne vlerë ALL 194,387,674 dhe shoqeria "GJONAJ GROUP HOLDINGS" SHPK do te zoteroje një kuote që perfaqeson 50% te kapitalit te shoqerise ne vleren ALL 194,387,674.
- Të japë pëlqimin që huaja që shoqëria "TOP FRUITS" SHPK ka ndaj ortakut Ejup Ahmeti në vlerën EUR 155,000 (njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë Euro) sipas Kontratës së Huazimit datë 23.11.2023 të kalojë si investim i ortakut Ejup Ahmeti në zmadhimin e kapitalit të shoqërisë sipas kundravleres ne lek **ALL 16,098,300** (EUR 155,000 kursi 103.86)
- Autorizimin e administratorit të shoqërisë, Z. Gentian Jahja për të kryer aplikimet dhe veprimet e nevojshme për regjistrimin e këtij vendimi në QKB.
- Urdhërohet zyra e financës të kryerjë përshtatjet e nevojshme në kontabilitetin e shoqërisë në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim regjistrohet në QKB dhe regjistrin e vendimeve të shoqërisë.

ORTAKËT E SHOQËRISË "TOP FRUITS" SHPK

Z. Ejup AHMETI

Ejup Ahmeti

Shoqëria "GJONAJ GROUP HOLDINGS" SHPK

Përfaqësuar nga Administratori:

Kristjan Zhomu

